Breaking News:

Lajmet Operacionet

23/05/2023

Mat – Finalizohet Operacioni Policor I Koduar "Lavazhi", Për Goditjen E Veprimtarisë Kriminale Të Shpërndarjes Së Lëndëve Narkotike

Mat

Finalizohet operacioni policor i koduar "Lavazhi", për goditjen e veprimtarisë kriminale të shpërndarjes së lëndëve narkotike.

Përdorte lavazhin që kishte marrë me qira, për të kamufluar veprimtarinë kriminale që kryente duke shpërndarë kokainë dhe kanabis, kapet dhe vihet në pranga 32-vjeçari. Në pranga dhe një shtetas tjetër që punonte në këtë lavazh.

Procedohet në gjendje të lirë pronari i lavazhit, pasi gjatë operacionit iu gjet një pushkë sportive.

Sekuestrohen në cilësinë e provës materiale dhjetëra doza kanabisi, një sasi kanabisi gati për paketim, doza kokaine, targa automjetesh shqiptare dhe të huaja që dyshohet se 32-vjeçari i përdorte për të kryer veprimtarinë kriminale, duke i vënë në mjete të ndryshme.

Strukturat për hetimin e krimeve të Komisariatit të Policisë Mat, në vijim të punës për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e narkotikëve, bazuar në inteligjencën informative se në një lavazh në unazën e qytetit të Burrelit shpërndaheshin lëndë narkotike kanabis dhe kokainë, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor antidrogë të koduar "Lavazhi".

Në kuadër të këtij operacioni u kapën dhe u vunë në pranga shtetasit:

L. H., 32 vjeç, banues në Burrel, i cili kishte marrë me qira lavazhin;

J. P., 39 vjeç, banues në Burrel, punëtor në këtë lavazh.

Gjithashtu, nisi procedimi në gjendje të lirë për shtetasin Y. N., banues në Burrel, pronari i lavazhit.

Gjatë kontrollit fizik ndaj shtetasit L. H. dhe kontrollit në ambientet e lavazhit që ai kishte marrë me qira, shërbimet e Policisë gjetën dhjetëra doza kanabisi, një sasi kanabisi gati për paketim dhe doza kokaine, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Gjithashtu, gjatë kontrollit në ambientet e lavazhit, Policia gjeti dhe sekuestroi edhe 10 targa automjetesh shqiptare dhe të huaja, që dyshohet se shtetasi L. H. i përdorte për automjete të ndryshme, me qëllim që të kamuflonte veprimtarinë kriminale, fishekë për armë gjahu, si dhe një pushkë sportive që i përkiste pronarit të lavazhit, shtetasit Y. N.

Gjatë kontrolit fizik, shtetasit J. P., punëtor në lavazh, iu gjet një sasi lëndë narkotike kokainë në doza.

Materialet procedurale do t'i refrohen Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, për veprime të mëtejshme.

Akademia e Sigurisë e Policisë së Shtetit, pjesëmarrëse në konferencën ndërkombëtare, me temë "Standardizimi i trajnimeve dhe i formimit të punonjësit bazë të Policisë"

Policia Rrugore e Tiranës, masa shtesë për menaxhimin e trafikut rrugor

Kërko
Enter a word for search

Komisariati Dixhital
GET IT ON Google Play
Download on the App Store

Arkiva
Select Month

Linqe
- Arkiva
- Akademia e Sigurisë
- Ministria e Brendshme
- Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- Interpol
- Europol
- Misioni PAMECA V
- SCPA
- Projekti Trivalent

Copyright © 2023 Policia e Shtetit. All rights reserved. Theme: ColorNews by ThemeGrill. Powered by WordPress.